


**APOSTOL PANGO**  
**(1937-2015)**

Apostol Pango lindi më 15.5.1937 në fshatin Topovë të Zagorisë të rrethit Gjirokastrë. Mësimet e para i mori në vendlindje dhe në Sheper. Shkollën e mesme pedagogjike e mbaroi në Shkodër, kurse studimet e larta i kreu në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Histori-Filologji, dega Histori më 1957-1961. Më pas punoi si mësues i historisë në shkollën e mesme të përgjithshme të qytetit të Delvinës (1961-1977) dhe si drejtor i Muzeut Historik të Sarandës (1977-1998).



Me krijimin e qendrave kulturore u emërua drejtor i Qendrës Kulturore Sarandë (1996-1998).

Krahas punës muzeale në qytetet Sarandë e Delvinë, në vitet 1974-1990, u bë ideator dhe zbatues projektesh për ngritjen e 20 muzeumeve në fshatrat e Sarandës. Ndër më kryesorët janë: Muzeu Historik, Delvinë (1974), Muzeu Historik Sarandë (1976), Muzeu Etnografik i rrethit Sarandë (1989), shtëpitë muze të Heronjve të Popullit Vasil Laçi e Mitro Xhani në Piqeras (1984), të Lefter Talos në Livadhja (1989) dhe të patriotit dhe rilindasit Hasan Tahsini në Ninat (1985). Gjithashtu ishte bashkautor i Muzeut të Arsimit Kombëtar në Korçë (1976), etj.

Njëkohësisht punoi edhe për nxjerrjen në dritë të dokumenteve historike për rrethet Sarandë e Delvinë duke i propaganduar ato në organet e shtypit të kohës, në konferenca e sesione shkencore, në fletëpalosje dhe, në revista shkencore. Në vitet 1980 botoi librat: “Luftëtarë të penës dhe pushkës” (1985), “Namik Delvina” (1996), “Enciklopedia e Delvinës dhe e Sarandës” (2002), “Enciklopedia e Zagorisë” (2004), “Delvina, histori e shkurtër” (2008), “Delvina në regjimet osmane” (2015).

Ka qenë bashkautor në librat “Hasan Tahsini” (1980) dhe “Enciklopedia arsimore” (2009). Në veprimtarinë e tij botuese përfshihen edhe rreth 30 broshura e fletëpalosje.

A.Pango ka qenë bashkëpunëtor në revistat “Studime historike”, “Studime pedagogjike” dhe “Nëntori” (1970-1989), në të cilat botoi 15 artikuj shkencorë. Ai gjithashtu është autor i disa zërave në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (1985, 2008-2009). Ishte mjaft i njohur edhe në shtypin periodik dhe atë edukativ-shkencor, në të cilin gjatë periudhës 1967-2014 botoi mbi 300 artikuj. Në vlerësim të punës së tij në vitin 1989 iu dha grada “Doktor i shkencave”.

Veprimtaria e larmishme e A.Pangos ishte rrjedhojë e një pasioni dhe këmbëngulje të spikatur. Në fushën e historisë ai u shqua për hulumtime të thelluara në arkiva e biblioteka. Ndërsa në fushën e muzeologjisë i kushtoi vëmendje të veçantë punës në terren. Një shtysë të madhe në punën studimore i dha edhe bashkëpunimi me profesorët më në zë të shkencave shoqërore të Institutit të Arkeologjisë, Etnografisë etj., si: prof. dr. Selami Pulaha, prof. Aleksandër Mexsi, prof. Dhimosten Budina, prof. dr. Gjerak Karaiskaj, prof. dr. Mevlan Kabo, prof. dr. Pirro Thomi, prof. dr. Hysni Myzyri etj. Lidhjet e tij me osmanistin e njohur Vexhi Buharanë, e ndihmuan në vazhdimësi për përpilimin e disa prej librave të botuar.

Me punën e palodhur për katër dekada A.Pango u bë një nga studiuesit kryesorë të popullsisë së trevave të jugut të Shqipërisë, të Çamërisë dhe të popullsisë minoritare greke. Njëherësh ai ishte organizator i konferencave dhe seminareve me temë historike, kulturore dhe arsimore. Nuk mund të mos përmendet edhe nxitja dhe përkrahja për historianët e rinj të dy rrethëve të jugut, Sarandës e Delvinës.

Vitet e fundit A.Pango jetonte me familjen e vet në Tiranë, ku edhe vdiq më 12.12.2015, ndërkohë që kishte në proces, hartimin e një libri të ri. La pas një trashëgimi të vyer që i shërben pasurimit të historiografisë dhe kulturës sonë dhe një model të pasionit dhe përkushtimit për studimin shkencor.

**MARENGLLEN VERLI  
HALIL SHABANI**